



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
DREJTORIA EKONOMIKE
SEKTORI I KUJDESIT SOCIAL

PROJEKT-VENDIM

Nr. 1 datë 21/01/2021

Mbi miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me fondin deri në 6 %

Në zbatim Ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të Ligjit 109/2017 “Për Buxhetin e vitit 2018”, të Ligjit 9355 date 10.03.2005 “Për Ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore” i ndryshuar, të VKM-së nr.955 datë 07.12.2016 “Për Përcaktimin e Kriterëve, të Procedurave, Dokumentacionit dhe Masës së Përfitimit të Ndhmës Ekonomike” si dhe Udhëzim nr.5 datë 17.02.2017 “Mbi Përdorimin e Fondit të Kushtëzuar për Bllok-Ndihmën Ekonomike deri në 6 %”, Pika 1; 2; 4; 6, i propozojmë Këshillit Bashkiak Dibër sa më poshtë:

Familjet të cilat, nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit, që të përfitojnë nga ndihmë ekonomike, duke përdorur Fondin 6%, duhet të plotësojnë disa kriterë:


Të përfitojnë familjet aplikuese të cilat plotësojnë këto kriterë:

1. Familje me një prind, (nga humbja e bashkëshortit/es; divorci, lidhje jashtëmartesore) ku përparësi të kenë gratë kryefamiljare. Këto familje do të përzgjidhen sipas vlerësimit si dhe numrit të anëtarëve të familjes (psh përfiton ajo familje e cila ka më shumë anëtarë).
2. Familje me 1 anëtar në kushte të vështira ekonomike, (të vetmuar, të divorcuar).
3. Familjet “Vajzë nënë” të cilat, nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit.
4. Familjet me probleme të dhunës në familje, (për shkaqe të ndryshme).
5. Familje të cilat kanë në përbërje persona me probleme shëndetësore të cilët janë të paaftë për të punuar.

6. Familje që kanë në përbërje të tyre anëtarë mbi moshë pune në kushte të vështira ekonomike.
7. Familje të cilat kanë në përbërje fëmijë të cilët kanë lindur më shumë se dy njëherësh.
8. Familje me më shumë se 5 anëtarë në kushte të vështira ekonomike.
9. Familjet që do të përzgjidhen duhet të jenë detyrimisht në listën e familjeve që kanë aplikuar Brenda 3 (tre) muajve të fundit në regjistrin elektronik për ndihmë ekonomike por që nuk janë shpallur përfitues nga sistemi i pikëzimit.
10. Për familjet që do t'i propozohen Këshillit të Bashkisë për miratim, duhet detyrimisht të jetë kryer paraprakisht vlerësimi social ekonomik në familje nga administrator shoqëror i Njësisë Administrative të cilës i përket, sipas VKM nr. 955 datë 07.12.2016 Për Përcaktimin e Kritereve, të Procedurave, Dokumentacionit dhe Masës së Përfitimit të Ndihmës Ekonomike”.
11. Në bazë të propozimeve të ardhura nga Njësitë Administrative për trajtim me ndihmë ekonomike në masën e kushtëzuar deri në 6%, Struktura përgjegjëse për shërbimet sociale në Bashki harton projektvendimin përkatës për familjet në nevojë që përfitojnë nga kjo skemë dhe miratohet në Këshillin e Bashkisë.
12. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Ekonomike, Sektori i Kujdesit Sociale dhe Njësitë Administrative.
13. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Prefekti.

Përgjegjës i Kujdesit Social

Ardit Hoxha





Përgjegjëse Sek. Juridik

Elona Lusha



KRYETAR

Dionis IMERAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM NR 02 Datë 03.02.2021

Mbi miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me fondin deri në 6 %

Në zbatim Ligjit 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", të Ligjit 109/2017 "Për Buxhetin e vitit 2018", të Ligjit 9355 date 10.03.2005 "Për Ndhimën dhe Shërbimet Shoqërore" i ndryshuar, të VKM-së nr.955 datë 07.12.2016 "Për Përcaktimin e Kriterëve, të Procedurave, Dokumentacionit dhe Masës së Përfitimit të Ndhimës Ekonomike" si dhe Udhëzim nr.5 datë 17.02.2017 "Mbi Përdorimin e Fondit të Kushtëzuar për Bllok-Ndhimën Ekonomike deri në 6 %", Pika 1; 2; 4; 6, i propozojmë Këshillit Bashkiak Dibër sa më poshtë:

Familjet të cilat, nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit, që të përfitojnë nga ndihmë ekonomike, duke përdorur Fondin 6%, duhet të plotësojnë disa kriterë: Këshillit Bashkiak të datës 03.02.2021 : me 17 vota pro 0 kundër 0 apstenim.

VENDOSI:

Të përfitojnë familjet aplikuese të cilat plotësojnë këto kriterë:

1. Familje me një prind, (nga humbja e bashkëshortit/es; divorci, lidhje jashtëmartesore) ku përparësi të kenë gratë kryefamiljare. Këto familje do të përzgjidhen sipas vlerësimit si dhe numrit të anëtarëve të familjes (psh përfiton ajo familje e cila ka më shumë anëtarë).
2. Familje me 1 anëtar në kushte të vështira ekonomike, (të vetmuar, të divorcuar).
3. Familjet "Vajzë nënë" të cilat, nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit.
4. Familjet me probleme të dhunës në familje, (për shkaqe të ndryshme).
5. Familje të cilat kanë në përbërje persona me probleme shëndetësore të cilët janë të paaftë për të punuar.
6. Familje që kanë në përbërje të tyre anëtarë mbi moshë pune në kushte të vështira ekonomike.
7. Familje të cilat kanë në përbërje fëmijë të cilët kanë lindur më shumë se dy njëherësh.
8. Familje me më shumë se 5 anëtarë në kushte të vështira ekonomike.

9. Familjet që do të përzgjidhen duhet të jenë detyrimisht në listën e familjeve që kanë aplikuar Brenda 3 (tre) muajve të fundit në regjistrin elektronik për ndihmë ekonomike por që nuk janë shpallur përfitues nga sistemi i pikëzimit.
10. Për familjet që do t'i propozohen Këshillit të Bashkisë për miratim, duhet detyrimisht të jetë kryer paraprakisht vlerësimi social ekonomik në familje nga administrator shoqëror i Njësisë Administrative të cilës i përket, sipas VKM nr. 955 datë 07.12.2016 Për Përcaktimin e Kritereve, të Procedurave, Dokumentacionit dhe Masës së Përfitimit të Ndhmës Ekonomike”.
11. Në bazë të propozimeve të ardhura nga Njësitë Administrative për trajtim me ndihmë ekonomike në masën e kushtëzuar deri në 6%, Struktura përgjegjëse për shërbimet sociale në Bashki harton projektvendimin përkatës për familjet në nevojë që përfitojnë nga kjo skemë dhe miratohet në Këshillin e Bashkisë.
12. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Ekonomike, Sektori i Kujdesit Sociale dhe Njësitë Administrative.
13. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Prefekti.



RASHKIA PESHKOPI
N. 421/10
DIBER/01 10/02/21



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Nr.159/ 1 prot.

Peshkopi, më 10.02.2021

Lenda : Mbi verifikimin e ligjshmerise te vendimit nr.02 date 03.02.2021

Drejtuar: BASHKISË DIBER

DIBER

Në mbështetje të ligjit *nr.107, date 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut"*, neni 16, pasi verifikova për efekt ligjshmërie vendimin e këshillit të bashkisë Diber, *Nr 02 datë 03.02.2021 "Për miratimin e kriterëve për familjeve në nevojë që do të trajtohen me fondin deri në 6%"*, vendosa miratimin në parim të kësaj vendimmarrje në kushtet e respektimit të legjislacionit aktual që rregullon marrëdhëniet juridike të specifikuara në pjesën hyrëse të aktit administrative objekt verifikimi dhe shqyrtimi.

PREFEKTI
- Nexhbedin SHEHU -